Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/458
Datë: 08.07.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 03.07.2024 nxjerr këtë:

# V E N D I M

1. **Riakreditohet dhe rivalidohet** me kusht Instituti Profesional "ATC" SH.P.K me adresë: Rruga "UÇK", nr. 62, Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 03.07.2024 deri 02.07.2027, për ofrim, vlerësim dhe certifikim të kualifikimeve të aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

   1.1 **Bërës Ëmbëlsirash,** Niveli III i KKK, lloji: Kualifikimet kombëtare profesionale (D) me 30 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit në 4 (katër) grupe numri i kandidatëve për 1 (një) grup mund të jetë maksimalisht 12 (dymbëdhjetë) kandidatë, në total 48 kandidatë brenda vitit. Kohëzgjatja e një cikli të trajnimit është 9 (nëntë) muaj, ku për një vit kalendarik institucioni do të mbaj 1 (një) cikel të trajnimit.

   1.2 **Picamen,** Niveli III i KKK, lloji: Kualifikimet kombëtare profesionale (D) me 17 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit në 6 (gjashtë) grupe për 1 (një) vit kalendarik, numri i kandidatëve për 1 (një) grup mund të jetë maksimalisht 12 (dymbëdhjetë) kandidatë në total 72 kandidatë brenda vitit. Kohëzgjatja e një cikli të trajnimit është 3 (tre) muaj, ku për një vit kalendarik institucioni do të mbaj 3 (tri) cikle të trajnimit me nga 2 (dy) grupe, ku secili grup mund të ketë maksimalisht 12 kandidatë.

   1.3 **Ndihmës Kuzhinier,** Niveli III i KKK, lloji: Kualifikimet kombëtare profesionale (D) me 13 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit në 6 (gjashtë) grupe për 1 (një) vit kalendarik, numri i kandidatëve për 1 (një) grup mund të jetë maksimalisht 12 (dymbëdhjetë) kandidatë, në total 72 kandidatë brenda vitit. Kohëzgjatja e një cikli të

trajnimit është 3 (tre) muaj, ku për një vit kalendarik institucioni do të mbaj 3 (tri) cikle të trajnimit me nga 2 (dy) grupe, ku secili grup mund të ketë maksimalisht 12 kandidatë.

1.4 **Instalues Elektrik,** Niveli III i KKK, lloji: Kualifikimet kombëtare profesionale (D) me 27 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit në 6 (gjashtë) grupe për 1 (një) vit kalendarik, numri maksimal i kandidatëve për 1 (një) grup është 11 (njëmbëdhjetë) kandidatë. Në total 66 (gjashtëdhjetëegjashtë) kandidatë brenda vitit kalendarik.

2. **Akreditohet dhe Validohet** me kusht Instituti Profesional "ATC" me adresë: Rruga "UÇK", nr. 62, Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 03.07.2024 deri 02.07.2027, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

2.1 **Kuzhinier**, Niveli IV i KKK, lloji: Kualifikimet kombëtare profesionale (D) me 25 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit në 6 (gjashtë) grupe për 1 (një) vit kalendarik, numri i kandidatëve për 1 (një) grup mund të jetë maksimalisht 12 (dymbëdhjetë) kandidatë, në total 72 kandidatë brenda vitit. Kohëzgjatja e një cikli të trajnimit është 9 (nëntë) muaj, ku për një vit kalendarik institucioni do të mbaj 1 (një) cikel me nga 4 (katër) grupe, ku secili grup mund të ketë maksimalisht 12 kandidatë.

3. Riakreditimi/rivalidimi dhe akreditimi/validimi i institucionit është aprovuar me kushtet si në vijim:

- Të funksionalizohen mekanizmat për sigurimin dhe vlerësimin e cilësisë brenda institucionit dhe të hartohen politikat për sigurimin e cilësisë;
- Të plotësohet infrastruktura e nevojshme për përsonat me aftësi të kufizuara përfshirë pjerrinen me pjerrtësi deri në 6 përqind, deren për qasje me gjërësi 1.10. metër dhe me kalueshmëri pa prag, ashensori nese është e nevojshme si edhe tualetet, po ashtu institucioni obligohet të ofroj dëshmi konkrete mbi zhvillimin e politikave dhe procedurave lidhur me vlerësimin e përsonave me aftësi të kufizuara;
- Institucioni të ketë staf përgjegjës të trajnuar për sigurin dhe shëndetin në punë;
- Institucioni duhet të siguroj kushte mikroklimatike sipas standardeve të Sigurisë dhe Shëndetit në punë ( ndriçim, lagështia, zhurmë, nxehtësia, ftohtë, pluhurit, etj);
- Institucioni duhet të siguroj Pajisjet Përsonale Mbrojtëse të profesionit/programit dhe që duhet të shfrytëzohen gjatë pjesës praktike nga kandidatët;
- Institucioni duhet të i siguroj udhëzimet e përgjithshme të vendosura në objekt për Siguri dhe Shëndet në Punë, mbrojtje nga zjarri dhe numrat emergjent;
- Institucioni duhet të siguroj udhëzimet në formë të shkruar për pajisjet e punës praktike që shfrytëzohen;

- Institucioni duhet të siguroj kandidatëve para fillimit te praktikes, udhëzimet për rreziqet në formë të shkruar;
- Institucioni duhet të siguroj shenjezim;
- Institucioni duhet të siguroj planin e daljes emergjente, si dhe planin për evakuim dhe shpëtim;
- Institucioni duhet të siguroj aparatet fikse kundër zjarrit;
- Institucioni duhet të siguroj ndihmën e parë dhe staf të certifikuara për dhënien e ndihmës së parë;
- Institucioni duhet të siguroj se vendi i punës praktike duhet të jetë gjithmonë i mirëmbajtur;
- Institucioni duhet të siguroj se pajisjet e punës praktike janë në rregull dhe të mirëmbajtura.

4. Institucioni obligohet të plotësoj kushtet si më lartë në afat 3 deri në 6 muaj nga marrja e këtij vendimi.

5. Obligohet AKK që brenda 3 muajve të realizoj procesin e monitorimit të institucionit dhe të sjell raportet vlerësuese në Këshill Drejtues.

6. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

**A r s y e t i m**

Instituti Profesional "ATC" me datë 19.05.2023 ka parashtruar në AKK kërkesë për riakreditim dhe rivalidim të institucionit për kualifikimet: Bërës ëmbëlsirash, Picamen, Ndihmës kuzhinier dhe Instalues Eletrik, ndërsa me datë 28.08.2023 ka parashtruar kërkesë për akreditim dhe validim të kualifikimit Kuzhinier niveli IV i KKK. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nga fushëveprimtaria e AKK-së ka caktuar ekipet e eksperteve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për akreditim/validim dhe riakreditim/rivalidim të kualifikimeve si më lartë.

Ekipet e ekspertëve pas shqyrtimit të dosjeve të aplikimit, me datë 04.03.2024 kanë realizuar vizitën tek Instituti Profesional "ATC", ndërsa me datë 28 dhe 29 Mars 2024 kanë përpiluar raportet vlerësuese për riakreditim dhe rivalidim për kualifikimet për të cilat institucioni ka parashtruar kërkesë për riakreditim dhe rivalidim, si dhe raportet vlerësuese për akreditim dhe validim të kualifikimit Kuzhinier. Raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje tek Këshillit Drejtues i AKK-së.

Tutje, Këshilli Drejtues i AKK-së në mbledhjen e datës 13.06.2024 pas analizimit të raporteve vlerësuese të ekipit të ekspertëve për kualifikimin Bërës Ëmbëlsirash niveli III i KKK, mori *vendim që raporti vlerësues i përpiluar me datë* 29.03.2024 nga ekipi i ekspertëve të jashtëm për